

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit M. N., nga Prishtina, kundër të paditurës K.E.K. në Prishtinë, për kompensimin e përkohshëm të pagave, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr. 749/2007, datë 12.5.2008, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr. 749/2007 datë 12.5.2008.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr. 749/2007, datë 12.5.2008, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, Cl.nr. 335/2006, datë 23.3.2007, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Me pjesën II të dispozitivit, është detyruar e paditura K.E.K në Prishtinë që paditësit, në emër të kompensimit të përkohshëm të pagës sipas marrëveshjes së lidhur mes të paditësit dhe të paditurës, nr. 2793, datë 02.8.2001, për kohën prej 1.9.2006 deri më 28.7.2007, t'ia paguajë shumën prej 630 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, kurse që nga data 1.3.2007 e derisa të ekzistojnë kushtet e parashikuara në marrëveshjen e përmendur, t'ia paguajë nga 105 € për çdo muaj.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me revizionin e të paditurës, me aktgjykimin Rev.I.nr.370/2008, datë 23.2.2009, e ka pranuar si të bazuar revizionin, kurse aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta i ka ndryshuar, ashtu që kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar, me arsyetimin se Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës është themeluar me Rregulloren nr. 2003/40 dhe ka filluar të funksionojë nga data 1.1.2004, kështu që detyrimet e të paditurit ndaj paditësit kanë pushuar së ekzistuari.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës rrjedh se paditësi ka paraqitur kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, s Rev. nr. 370/2008 datë 23 shkurt 2009.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës me aktgjykimin nr. KI 53/12 , KI 25/12, KI 100/12 dhe KI 49/13 datë 26.9.2012, e ka shpallur të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me arsyetimin se ka gjetur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Sipas Marrëveshjes për kompensim të përkohshëm të pagës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nr. 2793 datë 2.8.2001, palët ndërgjyqëse kanë parashikuar që paditësi, si shfrytëzues i të drejtës së kompensimit të përkohshëm të pagës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, të realizojë pagën prej 206 DM në muaj, ndërkaq pagesa sipas kësaj marrëveshjeje fillon prej datës 2.8.2001 dhe përfundon në ditën e funksionimit të Fondit për Sigurimin Pensional - Invalidor të Kosovës. E paditura, në cilësi të punëdhënësit, në bazë të nenit 14 të rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 datë 22.12.2001 “Për pensionet”, ka themeluar Fondin Suplementar Pensional nga i cili ka bërë pagesën e kompensimit për punëtorë. Bordi Ekzekutiv i të paditurës, me vendimin nr. ..., ka shfuqizuar vendimin dhe aktet e tjera në bazë të cilave ka themeluar Fondin Suplementar Pensional dhe ka ndërprerë financimin e këtij Fondi, duke filluar prej datës 1.9.2006. E paditura, deri në datën 31.8.2006, paditësit i ka paguar kompensimin për pagën - pensionin suplementar. Paditësi, duke qenë i pakënaqur me veprimin e të paditurës, ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e kompensimit të pagës.

Në bazë të kësaj gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, prandaj ankesën e të paditurës e ka refuzuar si të pabazuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se gjykatat e instancave më të ulëta, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, e kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se aktgjykimet e tyre nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, të datës 15.5.2009 (të përmendur në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese), Fondi i Sigurimit Invalidor dhe Pensional nuk është funksional. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/40 për shpalljen e Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund të përfitojnë nga kjo skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj, nuk e rregullon themelimin e sigurimeve pensionale dhe invalidore të vendit. Themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Pensionet Invalidore, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës. Në po këtë njoftim thuhet që në kohën e shkrimit të atij shënimi, pensioni inter alia ekzistonte si “pension invalidor në shumën e 45 €, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të këtij janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të plotë)” dhe si “pensione të kontributdhënësve prej 82 €, të cilat rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë gjithë pensionistët, që kanë arritur moshën e pensionit prej 65 vitesh dhe të cilët kanë 15 vjet përvojë pune)”.

Nisur nga provat e lartpërmendura del se e paditura ka vazhduar për t’ia paguar shumën e caktuar paditësit deri në vitin 2006, me gjithë faktin se Rregullorja nr. 2003/40 është me efekt veprimi prej datës 1.1.2004.

Duke marrë për bazë faktin se themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Pensionet Invalidore, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës, Gjykata Supreme vlerëson se ende qëndron detyrimi i të paditurës që ndaj paditësit t’i përmbushë obligimet sipas marrëveshjes së nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse, derisa të aprovohet Fondi apo paditësi të arrijë moshën e pleqërisë – 65 vjeç.

Për arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara thëniet në revizion se gjykatat e instancave më të ulëta e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Nga sa u parashtrua dhe me zbatimin e dispozitës nga neni 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.88/2016 datë 14.4.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku